

VENDIM
Nr. 754, datë 16.9.2015

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR SISTEMIN E
MENAXHIMIT TË STANDARDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14, të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS). Baza e të dhënave të DPS-së quhet Sistemi i Menaxhimit të Standardeve (SMS) - *Standards Management System*.

2. Sistemi i Menaxhimit të Standardeve (SMS) përmban të dhëna për:

- standardet shqiptare dhe dokumentet e standardizimit;
- ciklin e jetës së standardeve shqiptare;
- shitjet e standardeve (faturat, numrin e faqeve, çmimin për çdo standard, porositë/kërkesat për blerje standardesh dhe statusin e tyre);
- klientët dhe palët e interesuara (subjekti/personi, qyteti, adresa, standardi/et e kërkuara);
- punën teknike të standardeve.

3. Institucioni administrues i Sistemit të Menaxhimit të Standardeve është Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

4. Të dhënat parësore dhe dytësore të SMS-së janë, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhënat parësore:

- Standardet shqiptare dhe dokumentet e standardizimit;
- Cikli i jetës së standardeve shqiptare;
- Të dhëna për shitjet e standardeve;
- Të dhëna për klientët dhe palët e interesuara;
- Të dhëna për punën teknike të standardeve.

4.2 Të dhënat dytësore:

- Standardet e organizatave evropiane (CEN, CENELEC, ETSI);
- Standardet e organizatave ndërkombëtare (ISO, IEC dhe ITU-T).

5. Dhënës i informacionit, sa i përket SMS-së, është Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

6. Baza e të dhënave të DPS-së shkëmben informacione me institucionet publike e private, që ushtrojnë funksione publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, lidhur me statusin e standardeve shqiptare dhe fushat që lidhen me to. Gjithashtu, ajo ndërvepron me databazat e organizatave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe bazohet në të drejtat dhe detyrimet e statusit të anëtarësimit të DPS-së në këto organizata.

7. Subjektet e interesuara kanë nivel aksesit si lexues dhe konsultues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion, nëpërmjet faqes së internetit të DPS-së (Katalogu i Standardeve Shqiptare, puna teknike me standardet dhe porositë/kërkesat *on line*).

Për punonjësit e DPS-së niveli i aksesimit përcaktohet në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të SMS-së.

7.1 Baza e të dhënave të DPS-së ka 6 nivele përdoruesish (*users' levels*):

1. Niveli Administrator;
2. Niveli Raportues (*Report*);
3. Niveli Shitës standardesh (*Sale*);
4. Niveli Standard;
5. Niveli Standard PDF;

6. Niveli Standard, Shitje dhe lexues i PDF, (*Standard, Sale and PDF Read*).

Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në procedurat e punës, të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm i DPS-së për secilin nga punonjësit e saj.

8. Subjekte të interesuara për SMS, janë:

- biznesi dhe shoqatat tregtare;
- shoqatat e konsumatorit;
- trupat akademike (universitetet, studentët);
- trupat inspektuese dhe testuese;
- institucionet shtetërore dhe lokale;
- personat fizikë dhe juridikë;
- komitetet teknike të DPS-së.

9. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të SMS-së së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e standardizimit, do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama